

Raporti: “Pasqyra e Perceptimeve të Qytetarëve për Pellgun Ujor të Drinit të Bardhë në Kosovë”

Implementing the Strategic Action Programme
of the **DRIN BASIN** to Strengthen Transboundary
Cooperation and Enable Integrated Natural
Resources Management



Global Water
Partnership
Mediterranean



UNEP

Përmbajtja

Hyrja.....	4
Rezultatet e pyetësorit.....	5
Seksioni 1: Të dhëna të përgjithshme.....	5
Profili i respondentëve.....	5
Shpërndarja gjeografike.....	5
Profili profesional.....	5
Seksioni 2: Njohuritë dhe ndërgjegjësimi.....	6
Seksioni 3: Thatësitat dhe disponueshmëria e ujit.....	8
Seksioni 4: Perceptimet dhe prioritetet.....	12
Seksioni 5: Rekomandimet e qytetarëve.....	15
Shqetësimet kryesore të qytetarëve lidhur me lumenjtë dhe burimet ujore.....	15
Veprimet e rekomanduara nga qytetarët për mbrojtjen e Pellgut të Drinit.....	15
Sesioni i diskutimit online me qytetarët dhe palët e interesit.....	17
Rrjedha e sesionit dhe temat e diskutimit.....	17
Sfidat kryesore të identifikuara.....	18
Ndërhyrjet në lumenj dhe degradimi i ekosistemeve ujore.....	18
Ndikimi i hidrocentraleve në rrjedhat ujore.....	18
Problemet ndërkufitare dhe ndikimi i ndotjes në rrjedhat ujore të Pellgut të Drinit të Bardhë.....	19
Sfidat institucionale dhe qeverisja e burimeve ujore.....	20
Përfshirja e komunitetit dhe ndërgjegjësimi qytetar.....	21
Stresi hidrik dhe siguria e furnizimit me ujë.....	21
Rekomandimet e dala nga sesioni i diskutimit online.....	21
Pasqyra e shqetësimeve mbi ujërat: Raportime nga aktivistët dhe ekspertë të shëndetësisë.....	23
Thatësitat dhe shëndeti publik.....	23
1. Propozimi për menaxhimin e ndotjes ndërkufitare: Vendosja e ndaluesve të plastikës në Gjonaj (Prizren).....	24
2. Kuadri ligjor dhe historik i ujërave ndërkufitare.....	24
3. Ndërlidhja me ekoturizmin: Modelet EV6 dhe Sava Cycle Route.....	25
4. Propozim strategjik: Filtrimi i ujërave të zeza me impiante "ROTO" për mbrojtjen e drinit të bardhë dhe burimeve të ujit të pijshëm.....	25
5. Skema e financimit dhe vendosja e afateve ligjore.....	25
6. Pikat kritike të ndërhyrjes në Kosovë.....	26
7. Mbrojtja e bujqësisë: Sistemet Anti-Breshër "DELTA".....	26

8. Menaxhimi i integruar i resurseve ujore.....	26
9. Rregullimi dhe ndërtimi i ujëmbledhësve.....	27
Përmbledhje.....	28
Referencat dhe citimet.....	29

Hyrja

Raporti i perceptimeve të qytetarëve mbi Pellgun e Lumit Drin është hartuar nga **Rilindja Gjellbër**, me mbështetjen e projektit **The Drin II** dhe **Global Water Partnership Eastern Europe (GWP-CEE)**. Qëllimi i këtij raporti është të paraqesë perceptimet e qytetarëve lidhur me rëndësinë e Pellgut të Lumit Drin, gjendjen aktuale të burimeve ujore, sfidat kryesore mjedisore dhe nevojat për ndërhyrje në mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të këtij ekosistemi të rëndësishëm për Kosovën dhe rajonin.

Të dhënat e paraqitura në pjesën e parë të raportit janë mbledhur në mënyrë anonime përmes një pyetësoi elektronik të krijuar në Microsoft Forms, i cili është shpërndarë përmes rrjeteve sociale me qëllim përfshirjen e qytetarëve nga komuna të ndryshme të Kosovës. Përmes këtij procesi është synuar të kuptohet niveli i informimit dhe vetëdijesimit të publikut, perceptimet mbi gjendjen e lumenjve dhe burimeve ujore, si dhe shqetësimet kryesore të komuniteteve lidhur me menaxhimin e Pellgut të Drinit.

Përveç analizës së të dhënave nga anketa, raporti përfshin edhe rezultatet nga një **sesion diskutimi online me qytetarë**, i organizuar më **6 korrik 2026, nga ora 11:00 deri në ora 12:00**. Në këtë sesion morën pjesë **22 qytetarë nga komuna të ndryshme të Kosovës**, të cilët ndanë përvojat, shqetësimet dhe rekomandimet e tyre lidhur me gjendjen e Pellgut të Lumit Drin, menaxhimin e burimeve ujore dhe rolin e institucioneve në mbrojtjen e tyre. Diskutimi u dokumentua përmes shënimeve të mbajtura gjatë sesionit, ndërsa konkluzionet dhe rekomandimet e pjesëmarrësve janë reflektuar në pjesën e dytë të këtij raporti.

Pjesa e tretë e raportit përfshin **rekomandime dhe perspektiva nga aktivistë dhe profesionistë**. Kjo pjesë synon të ofrojë një këndvështrim më të gjerë mbi ndikimet mjedisore dhe shëndetësore që lidhen me menaxhimin e burimeve ujore, si dhe të paraqesë rekomandime konkrete për përmirësimin e mbrojtjes së Pellgut të Lumit Drin.

Përmes këtij raporti synohet të identifikohen sfidat kryesore që ndikojnë në Pellgun e Lumit Drin, përfshirë ndotjen e lumenjve, menaxhimin e mbetjeve, mungesën e ujit, ndikimet e ndryshimeve klimatike, degradimin e ekosistemeve ujore dhe nevojën për bashkëpunim më të madh ndërmjet institucioneve, komuniteteve dhe organizatave të shoqërisë civile.

Rezultatet e pyetësorit

Pyetësori përbëhej nga gjithsej **23 pyetje**, të ndara në pesë seksione kryesore:

- **Seksioni I – Të dhënat e përgjithshme**, që përfshinte pyetje mbi profilin demografik të respondentëve;
- **Seksioni II – Njohuritë dhe ndërgjegjësimi**, që synonte të vlerësonte nivelin e informimit të qytetarëve mbi Pellgun e Lumit Drin dhe rëndësinë e tij;
- **Seksioni III – Thatësitrat dhe disponueshmëria e ujit**, që trajtonte perceptimet mbi ndryshimet në burimet ujore, ndikimet e thatësirave dhe përgatitjen institucionale;
- **Seksioni IV – Perceptimet dhe prioritetet**, që përfshinte qëndrimet e qytetarëve mbi sfidat kryesore dhe masat prioritare për mbrojtjen e lumenjve dhe burimeve ujore;
- **Seksioni V – Rekomandimet e qytetarëve**, i cili përmes pyetjeve të hapura ka mbledhur sugjerime dhe rekomandime konkrete nga respondentët për përmirësimin e gjendjes së Pellgut të Drinit.

Anketa është realizuar me gjithsej **62 respondentë**, të cilët përfaqësojnë kategori të ndryshme të shoqërisë, përfshirë qytetarë, të rinj dhe studentë, përfaqësues të organizatave joqeveritare, sektorin privat, institucione publike dhe profesionistë nga fusha të ndryshme. Respondentët janë nga komuna të ndryshme të Kosovës, përfshirë Prishtinën, Prizrenin, Pejën, Gjakovën, Suharekën, Ferizajn, Drenasin, Klinën, Junikun, Istogun, Deçanin dhe komuna të tjera, duke ofruar një pasqyrë të perceptimeve qytetare në nivel vendi.

Seksioni 1: Të dhëna të përgjithshme

Profili i respondentëve

Sa i përket përbërjes demografike të respondentëve, pjesa më e madhe e tyre i përket grupmoshës **25–34 vjeç (50%)**, e ndjekur nga grupmosha **18–24 vjeç (29%)**, çka tregon një pjesëmarrje të lartë të të rinjve në këtë vlerësim. Në aspektin gjinor, **66% e respondentëve janë femra**, ndërsa **34% janë meshkuj**.

Ky rezultat tregon se anketa ka arritur kryesisht të rinjtë dhe të rriturit e rinj, të cilët përbëjnë një grup me potencial të lartë për angazhim në nisma mjedisore dhe procese vendimmarrëse.

Shpërndarja gjeografike

Respondentët përfaqësojnë disa komuna të Kosovës, me pjesëmarrje më të madhe nga Prishtina dhe Prizreni, ndërsa janë përfaqësuar edhe Peja, Gjakova, Ferizaj, Deçani, Istogu, Juniku, Skenderaj, Suharekë, Klinë dhe komuna të tjera.

Kjo shpërndarje gjeografike ofron një perspektivë më të gjerë mbi perceptimet e qytetarëve dhe mundëson identifikimin e sfidave të përbashkëta në rajone të ndryshme.

Profili profesional

Në anketë kanë marrë pjesë përfaqësues nga sektorë të ndryshëm, duke përfshirë:

- studentë;
- qytetarë;
- organizata të shoqërisë civile;
- sektorin privat;
- institucione publike;
- profesionistë nga fusha e arsimit dhe shëndetësisë.

Seksioni 2: Njohuritë dhe ndërgjegjësimi

Nga përgjigjet e mbledhura në pyetjen “Sa jeni të njohur me Pellgun e Lumit Drin dhe rëndësinë e tij për Kosovën dhe rajonin?”, rezultojnë se niveli i njohurive është kryesisht mesatar, me shumicën e respondentëve që kanë një njohuri të pjesshme për këtë çështje.

Rezultatet:

- Shumë i/e njohur: 8%
- I/e njohur: 18%
- Deri diku i/e njohur: 50%
- Nuk jam i/e njohur: 24%

Të dhënat tregojnë se mbi gjysma e respondentëve (50%) kanë njohuri të pjesshme për Pellgun e Lumit Drin dhe rëndësinë e tij, ndërsa vetëm 8% deklarojnë se janë shumë të njohur me këtë temë. Në anën tjetër, rreth një e pesta e të anketuarve (24%) nuk kanë njohuri për Pellgun e Drinit.

Kjo tregon nevojën për rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimin publik mbi rëndësinë ekologjike, ekonomike dhe sociale të Pellgut të Lumit Drin, si dhe rolin e tij për menaxhimin e burimeve ujore në Kosovë dhe rajon.

Për pyetjen “Si do ta vlerësonit gjendjen aktuale të lumenjve dhe burimeve ujore në zonën tuaj?” janë pranuar këto përgjigje:

- E dobët: 55%
- Mesatare: 31%
- Shumë e dobët: 11%
- E mirë: 3%
- Shumë e mirë: 0%

Rezultatet tregojnë një perceptim kryesisht negativ të qytetarëve për gjendjen aktuale të lumenjve dhe burimeve ujore në zonat e tyre. Më shumë se gjysma e respondentëve (55%) e vlerësojnë gjendjen si të dobët, ndërsa një përqindje shtesë prej 11% e konsiderojnë atë shumë të dobët. Kjo nënkupton se rreth dy të tretat e pjesëmarrësve kanë një vlerësim jo pozitiv për gjendjen e burimeve ujore.

Në anën tjetër, vetëm 3% e respondentëve e vlerësojnë gjendjen si të mirë, ndërsa asnjë respondent nuk ka deklaruar se gjendja është shumë e mirë. Këto rezultate pasqyrojnë shqetësimin e qytetarëve për problemet që ndikojnë në lumenj dhe burimet ujore, duke theksuar nevojën për masa më të fuqishme në mbrojtjen e ujërave, parandalimin e ndotjes dhe menaxhimin më të qëndrueshëm të resurseve ujore.

Për pyetjen “Sa të rëndësishëm i konsideroni lumenjtë dhe burimet ujore të shëndetshme për komunitetin tuaj?” janë pranuar me rezultatet si më poshtë:

- Shumë të rëndësishëm: 82.3%
- Të rëndësishëm: 17.7%
- Mesatarisht të rëndësishëm: 0%
- Pak të rëndësishëm: 0%
- Aspak të rëndësishëm: 0%

Rezultatet tregojnë një vetëdije të lartë të qytetarëve për rëndësinë e lumenjve dhe burimeve ujore të shëndetshme për komunitetin. Pjesa më e madhe e respondentëve (82.3%) i konsiderojnë këto burime si shumë të rëndësishme, ndërsa 17.7% i vlerësojnë si të rëndësishme.

Fakti që asnjë respondent nuk i ka konsideruar lumenjtë dhe burimet ujore si mesatarisht, pak ose aspak të rëndësishme tregon një pajtim të plotë mbi rolin thelbësor të ujit për komunitetet, shëndetin publik, zhvillimin ekonomik dhe ruajtjen e mjedisit. Kjo gjithashtu tregon se, pavarësisht shqetësimeve për gjendjen aktuale të lumenjve, qytetarët e njohin vlerën dhe nevojën për mbrojtjen e tyre.

Për pyetjen “Cilat mendoni se janë sfidat kryesore mjedisore që ndikojnë në lumenjtë dhe burimet ujore?” (me mundësi për të zgjedhur deri në 3 përgjigje), rezultatet paraqiten si më poshtë:

- Ndotja nga mbeturinat: 88.7%
- Ujërat e zeza të patrajtuara: 80.6%
- Degradimi i rrjedhave të lumenjve: 38.7%
- Mungesa e ndërgjegjësimit mjedisor: 33.9%
- Shfrytëzimi i tepruar i ujit: 16.1%
- Humbja e biodiversitetit: 16.1%
- Aktivitetet e paqëndrueshme turistike: 14.5%
- Ndryshimet klimatike: 9.7%
- Tjetër: 1.6%

Rezultatet tregojnë se qytetarët i perceptojnë ndotjen nga mbeturinat dhe ujërat e zeza të patrajtuara si dy sfidat kryesore që ndikojnë në gjendjen e lumenjve dhe burimeve ujore.

Pothuajse 9 nga 10 respondentë kanë identifikuar mbeturinat si një nga problemet kryesore, ndërsa mbi 80% kanë theksuar problemin e shkarkimit të ujërave të zeza pa trajtim.

Përveç ndotjes direkte, respondentët kanë evidentuar edhe probleme të tjera si degradimi i rrjedhave të lumenjve dhe mungesa e ndërgjegjësimit mjedisor, të cilat ndikojnë në mbrojtjen dhe menaxhimin afatgjatë të burimeve ujore.

Këto rezultate tregojnë se qytetarët i lidhin problemet kryesore të lumenjve jo vetëm me mungesën e infrastrukturës për menaxhimin e ujërave dhe mbetjeve, por edhe me nevojën për rritjen e përgjegjësisë dhe ndërgjegjësimit publik për mbrojtjen e mjedisit.

Seksioni 3: Thatësitrat dhe disponueshmëria e ujit

Për pyetjen “Gjatë pesë viteve të fundit, a keni vërejtur ndryshime në disponueshmërinë e ujit në zonën tuaj?” janë pranuar këto rezultate:

- Ulje të konsiderueshme: 30.6%
- Ulje të lehtë: 30.6%
- Nuk kam vërejtur ndryshim: 16.1%
- Nuk jam i/e sigurt: 16.1%
- Rritje të lehtë: 4.8%
- Rritje të konsiderueshme: 1.6%

Rezultatet tregojnë se shumica e respondentëve kanë vërejtur një rënie të disponueshmërisë së ujit gjatë pesë viteve të fundit në zonat e tyre. Rreth 61.2% e pjesëmarrësve kanë deklaruar se kanë vërejtur ulje të sasisë së ujit, ku 30.6% raportojnë një ulje të konsiderueshme, ndërsa 30.6% një ulje të lehtë.

Në anën tjetër, vetëm një përqindje e vogël e respondentëve kanë perceptuar rritje të disponueshmërisë së ujit, me 4.8% që kanë vërejtur rritje të lehtë dhe vetëm **1.6%** rritje të konsiderueshme. Ndërkohë, 16.1% nuk kanë vërejtur ndryshim, ndërsa po aq (**16.1%**) janë shprehur se nuk janë të sigurt.

Këto rezultate tregojnë një perceptim të qartë të komunitetit për uljen e disponueshmërisë së burimeve ujore, duke theksuar nevojën për menaxhim më të qëndrueshëm të ujit, përmirësim të infrastrukturës ujore dhe masa për përballimin e ndikimeve të ndryshimeve klimatike.

Për pyetjen “Sa të shqetësuar jeni për ndikimin e thatësirave në komunitetin tuaj?” janë pranuar këto rezultate:

- Shumë i/e shqetësuar: 41.9%
- I/e shqetësuar: 33.9%
- Mesatarisht i/e shqetësuar: 17.7%
- Pak i/e shqetësuar: 3.2%
- Aspak i/e shqetësuar: 3.2%

Rezultatet tregojnë se shumica e respondentëve janë të shqetësuar për ndikimin e thatësirave në komunitetin e tyre. Gjithsej 75.8% e pjesëmarrësve deklarojnë se janë të shqetësuar ose shumë të shqetësuar, ku 41.9% shprehen se janë shumë të shqetësuar, ndërsa 33.9% janë të shqetësuar.

Një pjesë më e vogël e respondentëve (17.7%) e vlerësojnë shqetësimin si mesatar, ndërsa vetëm 6.4% kanë deklaruar se janë pak ose aspak të shqetësuar për ndikimin e thatësirave.

Këto rezultate tregojnë se thatësitat perceptohen si një sfidë serioze nga qytetarët, duke reflektuar shqetësime për ndikimet e mundshme në furnizimin me ujë. Kjo nënvizon nevojën për masa parandaluese, menaxhim më efikas të burimeve ujore dhe përgatitje më të mirë ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike.

Për pyetjen “A keni përjetuar personalisht pasoja nga thatësitat ose mungesa e ujit gjatë viteve të fundit?” janë pranuar këto rezultate:

- Po: 72.6%
- Jo: 12.9%
- Nuk jam i/e sigurt: 14.5%

Rezultatet tregojnë se një pjesë e madhe e respondentëve kanë përjetuar drejtpërdrejt pasoja nga thatësitat ose mungesa e ujit gjatë viteve të fundit. Rreth 72.6% e pjesëmarrësve kanë deklaruar se kanë hasur në pasoja të tilla, ndërsa vetëm 12.9% kanë deklaruar se nuk kanë përjetuar ndikime të tilla.

Ndërkohë, 14.5% e respondentëve janë shprehur se nuk janë të sigurt nëse kanë përjetuar pasoja nga thatësitat ose mungesa e ujit.

Këto rezultate tregojnë se mungesa e ujit dhe ndikimet e thatësirave janë përvoja reale për shumicën e komunitetit, duke theksuar rëndësinë e masave për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore, përmirësimin e furnizimit me ujë dhe rritjen e përgatitjes ndaj periudhave të thata.

Për pyetjen “Nëse po, cilat pasoja keni përjetuar?” (Mund të zgjidhni më shumë se një përgjigje), rezultatet janë:

- Kufizime ose ndërprerje të furnizimit me ujë: 80.6%
- Tharje të lumenjve, përrenjve ose burimeve ujore: 53.2%
- Rritje të kostove që lidhen me përdorimin e ujit: 30.6%
- Humbje të vegetacionit ose biodiversitetit: 29.0%
- Ulje të prodhimit bujqësor: 25.8%
- Ndikime negative në turizëm dhe rekreacion: 11.3%
- Tjetër: 6.5%

Rezultatet tregojnë se pasoja më e shpeshtë e përjetuar nga qytetarët si rezultat i thatësirave dhe mungesës së ujit janë kufizimet ose ndërprerjet në furnizimin me ujë, të raportuara nga 80.6% e

respondentëve. Kjo pasohet nga tharja e lumenjëve, përrenjve dhe burimeve ujore, e evidentuar nga 53.2% e pjesëmarrësve.

Përveç ndikimeve direkte në qasjen ndaj ujit, qytetarët kanë raportuar edhe pasoja ekonomike dhe mjedisore, përfshirë rritjen e kostove të përdorimit të ujit, uljen e prodhimit bujqësor dhe humbjen e vegjetacionit ose biodiversitetit.

Këto të dhëna tregojnë se thatësitat nuk perceptohen vetëm si një problem mjedisor, por si një sfidë që prek drejtpërdrejt jetën e përditshme të komuniteteve, ekonominë lokale dhe ekosistemet ujore.

Për pyetjen “Sipas mendimit tuaj, cilat janë shkaqet kryesore të thatësirave dhe mungesës së ujit?” (me mundësi për të zgjedhur deri në 3 përgjigje), janë pranuar rezultatet:

- Ndotja e burimeve ujore: 74.2%
- Ndryshimet klimatike: 61.3%
- Përdorimi jo i qëndrueshëm i ujit: 58.1%
- Rënia e sasisë së reshjeve: 38.7%
- Infrastruktura e vjetruar ose joefikase: 33.9%
- Shpyllëzimi: 32.3%
- Tjetër: 1.6%

Rezultatet tregojnë se qytetarët i perceptojnë disa faktorë të ndërlidhur si shkaktarë kryesorë të thatësirave dhe mungesës së ujit. Sfidat e identifikuar më shpesh është ndotja e burimeve ujore, e përzgjedhur nga 74.2% e respondentëve, e ndjekur nga ndryshimet klimatike (61.3%) dhe përdorimi jo i qëndrueshëm i ujit (58.1%).

Përveç faktorëve klimatikë dhe mënyrës së menaxhimit të ujit, respondentët kanë theksuar edhe ndikimin e faktorëve të tjerë si rënia e sasisë së reshjeve, infrastruktura e vjetruar ose joefikase dhe shpyllëzimi.

Këto rezultate tregojnë se qytetarët e shohin mungesën e ujit si rezultat të një kombinimi faktorësh natyrorë dhe njerëzorë, duke nënvizuar nevojën për masa të integruara që përfshijnë mbrojtjen e burimeve ujore, përdorimin racional të ujit, përmirësimin e infrastrukturës dhe përshtatjen ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike.

Për pyetjen “Sa të përgatitura i konsideroni institucionet lokale për t’u përballur me thatësitat?” janë pranuar rezultatet:

- Shumë të përgatitura: 1.6%
- Të përgatitura: 3.2%
- Deri diku të përgatitura: 11.3%

- Pak të përgatitura: 38.7%
- Aspak të përgatitura: 37.1%
- Nuk e di: 8.1%

Rezultatet tregojnë një perceptim të ulët të qytetarëve për nivelin e përgatitjes së institucioneve lokale ndaj thatësirave. Shumica e respondentëve (75.8%) konsiderojnë se institucionet janë pak ose aspak të përgatitura, ku 38.7% i vlerësojnë si pak të përgatitura dhe 37.1% si aspak të përgatitura.

Vetëm një përqindje shumë e vogël e pjesëmarrësve kanë vlerësim pozitiv, ku 3.2% i konsiderojnë institucionet si të përgatitura dhe vetëm 1.6% si shumë të përgatitura. Ndërkohë, 11.3% mendojnë se institucionet janë deri diku të përgatitura, ndërsa 8.1% nuk kanë një qëndrim të caktuar.

Këto rezultate tregojnë një mungesë besimi të qytetarëve në kapacitetet aktuale institucionale për menaxhimin e periudhave të thatësirave dhe theksojnë nevojën për forcimin e planifikimit, koordinimit institucional, masave parandaluese dhe investimeve në menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore.

Për pyetjen “Cilat masa duhet të kenë prioritet për të reduktuar rrezikun nga thatësitat?” (me mundësi për të zgjedhur deri në 3 përgjigje), janë pranuar rezultatet:

- Mbrojtja e burimeve ujore: 83.9%
- Përmirësimi i infrastrukturës ujore: 53.2%
- Pyllëzimi dhe restaurimi i ekosistemeve: 43.5%
- Fushata për kursimin e ujit: 35.5%
- Politika dhe masa më të forta zbatuese: 33.9%
- Sisteme më efikase të ujitjes: 22.6%
- Sisteme monitorimi dhe paralajmërimi të hershëm: 21.0%
- Bashkëpunim ndërkufitar për menaxhimin e ujërave: 6.5%

Rezultatet tregojnë se qytetarët e konsiderojnë mbrojtjen e burimeve ujore si masën më të rëndësishme për reduktimin e rrezikut nga thatësitat, e përzgjedhur nga 83.9% e respondentëve. Kjo pasohet nga përmirësimi i infrastrukturës ujore (53.2%) dhe pyllëzimi dhe restaurimi i ekosistemeve (43.5%).

Respondentët kanë theksuar gjithashtu rëndësinë e masave që lidhen me ndërgjegjësimin dhe menaxhimin më të mirë të ujit, përfshirë fushatat për kursimin e ujit (35.5%) dhe politikat dhe masat më të forta zbatuese (33.9%).

Rezultatet tregojnë se qytetarët e shohin reduktimin e ndikimit të thatësirave si një proces që kërkon ndërthurjen e masave mjedisore, institucionale dhe infrastrukturore. Prioritetet e identifikuar nënvizojnë nevojën për mbrojtjen aktive të burimeve ujore, investime në infrastrukturë, rikthimin e ekosistemeve natyrore dhe forcimin e zbatimit të politikave për menaxhimin e ujit.

Seksioni 4: Perceptimet dhe prioritetet

Për pyetjen “Sa e rëndësishme është mbrojtja e Pellgut të Drinit për brezat e ardhshëm?” janë pranuar rezultatet:

- Shumë e rëndësishme: 88.7%
- E rëndësishme: 9.7%
- Mesatarisht e rëndësishme: 1.6%
- Pak e rëndësishme: 0%
- Aspak e rëndësishme: 0%

Rezultatet tregojnë një pajtim pothuajse të plotë të qytetarëve për rëndësinë e mbrojtjes së Pellgut të Lumit Drin për brezat e ardhshëm. Shumica dërmuese e respondentëve (88.7%) e konsiderojnë këtë çështje shumë të rëndësishme, ndërsa 9.7% e vlerësojnë si të rëndësishme.

Vetëm 1.6% e respondentëve e kanë konsideruar mbrojtjen e Pellgut të Drinit si mesatarisht të rëndësishme, ndërsa asnjë pjesëmarrës nuk ka deklaruar se kjo çështje është pak ose aspak e rëndësishme.

Këto rezultate tregojnë një nivel të lartë të vetëdijesimit dhe përgjegjësisë së qytetarëve për rëndësinë afatgjatë të mbrojtjes së Pellgut të Drinit, duke e parë atë si një burim të rëndësishëm natyror për sigurinë ujore, ruajtjen e biodiversitetit dhe mirëqenien e gjeneratave të ardhshme.

Për pyetjen “Cilët aktorë duhet të kenë rolin kryesor në mbrojtjen e lumenjve dhe burimeve ujore?” (me mundësi për të zgjedhur deri në 3 përgjigje), janë pranuar rezultatet:

- Institucionet qendrore: 88.7%
- Komunat: 83.9%
- Qytetarët: 48.4%
- Komunitetet lokale: 21.0%
- Bizneset: 17.7%
- Organizatat joqeveritare: 14.5%
- Institucionet arsimore: 12.9%
- Mediat: 9.7%
- Organizatat ndërkombëtare: 3.2%
- Tjetër: 0%

Rezultatet tregojnë se qytetarët e shohin përgjegjësinë kryesore për mbrojtjen e lumenjve dhe burimeve ujore tek institucionet publike, veçanërisht tek institucionet qendrore (88.7%) dhe komunat (83.9%). Kjo tregon një perceptim të qartë se menaxhimi dhe mbrojtja e burimeve ujore kërkon angazhim të fortë institucional dhe koordinim ndërmjet niveleve të qeverisjes.

Përveç institucioneve, një pjesë e konsiderueshme e respondentëve (48.4%) kanë identifikuar edhe **qytetarët** si aktorë të rëndësishëm në këtë proces, duke theksuar rolin e komunitetit në ruajtjen e mjedisit dhe përdorimin e përgjegjshëm të burimeve ujore.

Ndërkohë, bizneset, komunitetet lokale, organizatat joqeveritare dhe institucionet arsimore janë parë gjithashtu si pjesë e rëndësishme e zgjidhjes, megjithëse me një përqindje më të ulët. Këto rezultate sugjerojnë se qytetarët e perceptojnë mbrojtjen e lumenjve si një përgjegjësi të përbashkët, ku institucionet duhet të udhëheqin procesin, ndërsa komuniteti dhe aktorët e tjerë duhet të kontribuojnë në zbatim dhe ndërgjegjësim.

Për pyetjen “A mendoni se qytetarët kanë mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrjen për çështjet mjedisore?” janë pranuar rezultatet:

- Po: 17.7%
- Pjesërisht: 43.5%
- Jo: 25.8%
- Nuk e di: 12.9%

Rezultatet tregojnë se qytetarët kanë një perceptim të kufizuar për mundësitë e tyre për të marrë pjesë në vendimmarrjen lidhur me çështjet mjedisore. Vetëm 17.7% e respondentëve mendojnë se qytetarët kanë mundësi të mjaftueshme për pjesëmarrje, ndërsa 43.5% konsiderojnë se kjo mundësi ekziston vetëm pjesërisht.

Në anën tjetër, 25.8% e pjesëmarrësve besojnë se qytetarët nuk kanë mundësi për të ndikuar në proceset vendimmarrëse, ndërsa 12.9% nuk kanë një qëndrim të qartë për këtë çështje.

Këto rezultate tregojnë nevojën për forcimin e mekanizmave të pjesëmarrjes publike, rritjen e transparencës institucionale dhe krijimin e hapësirave më efektive që qytetarët dhe komunitetet të përfshihen në vendimmarrjen për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e burimeve ujore.

Për pyetjen “Cilat veprime duhet të kenë prioritet për përmirësimin e gjendjes së lumenjve dhe burimeve ujore?” (me mundësi për të zgjedhur deri në 3 përgjigje), janë pranuar rezultatet:

- Menaxhim më i mirë i mbeturinave: 72.6%
- Zbatim më i fortë i ligjit: 71.0%
- Edukim dhe ndërgjegjësim mjedisor: 66.1%
- Përmirësim i trajtimit të ujërave të zeza: 38.7%
- Projekte për restaurimin e lumenjve: 25.8%
- Masa për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike: 14.5%
- Më shumë konsultime publike: 6.5%
- Bashkëpunim ndërkufitar: 3.2%
- Iniciativa për turizëm të qëndrueshëm: 1.6%

Rezultatet tregojnë se qytetarët i konsiderojnë menaxhimin më të mirë të mbeturinave, zbatimin më të fortë të ligjit dhe edukimin dhe ndërgjegjësimin mjedisor si tri veprimet kryesore që duhet të kenë prioritet për përmirësimin e gjendjes së lumenjve dhe burimeve ujore.

Konkretisht, 72.6% e respondentëve kanë identifikuar menaxhimin e mbeturinave si një prioritet, ndërsa 71.0% kanë theksuar nevojën për zbatim më të fortë të legjislacionit mjedisor. Po ashtu, 66.1% e qytetarëve kanë vlerësuar edukimin dhe ndërgjegjësimin mjedisor si një masë të rëndësishme për përmirësimin afatgjatë të gjendjes së ujërave.

Përveç këtyre, respondentët kanë theksuar nevojën për përmirësimin e trajtimit të ujërave të zeza dhe realizimin e projekteve për restaurimin e lumenjve. Këto rezultate tregojnë se qytetarët e shohin mbrojtjen e lumenjve si një proces që kërkon kombinimin e masave institucionale, investimeve në infrastrukturë dhe angazhimit të komunitetit.

Për pyetjen “Sa të gatshëm jeni të merrni pjesë në aktivitete për mbrojtjen e lumenjve dhe burimeve ujore?” janë pranuar rezultatet:

- Shumë i/e gatshëm: 45.2%
- I/e gatshëm: 30.6%
- Neutral: 17.7%
- Jo shumë i/e gatshëm: 6.5%
- Aspak i/e gatshëm: 0%

Rezultatet tregojnë një gatishmëri të lartë të qytetarëve për t’u përfshirë në aktivitete që lidhen me mbrojtjen e lumenjve dhe burimeve ujore. Rreth 75.8% e respondentëve kanë deklaruar se janë të gatshëm ose shumë të gatshëm për të marrë pjesë në aktivitete të tilla, ku 45.2% shprehen shumë të gatshëm dhe 30.6% të gatshëm.

Ndërkohë, 17.7% e pjesëmarrësve kanë mbajtur një qëndrim neutral, ndërsa vetëm 6.5% kanë deklaruar se janë jo shumë të gatshëm për përfshirje. Asnjë respondent nuk ka deklaruar se nuk është aspak i gatshëm të marrë pjesë.

Këto rezultate tregojnë një potencial të mirë për angazhimin qytetar në iniciativa mjedisore dhe sugjerojnë se ekziston gatishmëri për bashkëpunim në aktivitete që synojnë mbrojtjen e lumenjve, përmirësimin e gjendjes së burimeve ujore dhe rritjen e ndërgjegjësimin në komunitet.

Seksioni 5: Rekomandimet e qytetarëve

Ky seksion përbëhet nga **dy pyetje të hapura**, përmes të cilave qytetarët kanë pasur mundësi të shprehin në mënyrë të lirë shqetësimet kryesore lidhur me gjendjen e lumenjve dhe burimeve ujore, si dhe të paraqesin rekomandime konkrete për institucionet dhe akterët relevantë për mbrojtjen dhe menaxhimin më të mirë të Pellgut të Lumit Drin.

Përgjigjet e mbledhura në këtë seksion ofrojnë një pasqyrë më të drejtpërdrejtë të përvojave, perceptimeve dhe pritshmërive të komunitetit, duke plotësuar të dhënat sasiore të pjesëve të tjera të raportit.

Shqetësimet kryesore të qytetarëve lidhur me lumenjtë dhe burimet ujore

Nga përgjigjet e mbledhura, vërehet se shqetësimi dominues i qytetarëve lidhet me ndotjen e lumenjve dhe degradimin e burimeve ujore. Shumë respondentë kanë përmendur ndotjen nga

mbeturinat, ujërat e zeza të patrajtuara dhe shkarkimet e pakontrolluara, duke e konsideruar këtë si një nga kërcënimet kryesore për cilësinë e ujit dhe shëndetin e ekosistemeve.

Përveç ndotjes, qytetarët kanë identifikuar edhe shqetësime të tjera të rëndësishme, si:

- Mungesa dhe zvogëlimi i burimeve ujore, përfshirë frikën nga thatësitat dhe uljen e disponueshmërisë së ujit në të ardhmen;
- Shkatërrimi i rrjedhave natyrore të lumenjve, veçanërisht përmes nxjerrjes së zhavorrit, ndërtimeve dhe ndërhyrjeve të pakontrolluara;
- Shfrytëzimi i tepërt dhe jo i qëndrueshëm i ujit, sidomos nga bizneset dhe aktivitetet ekonomike;
- Humbja e biodiversitetit dhe degradimi i ekosistemeve ujore;
- Mungesa e mirëmbajtjes dhe monitorimit të vazhdueshëm të lumenjve dhe burimeve ujore;
- Mungesa e ndërgjegjësimit qytetar dhe edukimit mjedisor për përdorimin dhe mbrojtjen e ujit.

Disa respondentë kanë theksuar edhe ndikimin e drejtpërdrejtë të problemeve me ujërat në shëndetin publik, veçanërisht në zonat ku mungesa ose kontaminimi i ujit ndikon në higjienën dhe mirëqenien e komuniteteve.

Veprimet e rekomanduara nga qytetarët për mbrojtjen e Pellgut të Drinit

Në lidhje me masat që duhet të ndërmerren nga institucionet, qytetarët kanë kërkuar një angazhim më të madh institucional dhe zbatim më efektiv të ligjeve mjedisore. Rekomandimet kryesore të identifikuara janë:

- **Forcimi i zbatimit të ligjit dhe rritja e kontrolleve inspektuese**, përfshirë ndëshkime më të ashpra për ndotësit dhe subjektet që dëmtojnë lumenjtë;
- **Investime në trajtimin e ujërave të zeza dhe përmirësimin e infrastrukturës ujore**, për të parandaluar shkarkimet e patrajtuara në lumenj;
- **Monitorim i vazhdueshëm i cilësisë së ujit dhe gjendjes së lumenjve**;
- **Mbrojtja e rrjedhave natyrore të lumenjve dhe ndalimi i aktiviteteve degraduese**, si nxjerrja e pakontrolluar e zhavorrit dhe ndërtimet pa leje;
- **Menaxhim më i mirë i mbeturinave dhe organizim i aksioneve të pastrimit**;
- **Fushata të vazhdueshme për ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi rëndësinë e kursimit dhe mbrojtjes së ujit**;
- **Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve qendrore, komunave, komuniteteve dhe organizatave të shoqërisë civile**.

Në përgjithësi, përgjigjet tregojnë se qytetarët e shohin mbrojtjen e Pellgut të Drinit si një përgjegjësi të përbashkët, por presin që institucionet publike të kenë rol udhëheqës përmes politikave më të fuqishme, investimeve dhe zbatimit efektiv të legjislacionit.

Sesioni i diskutimit online me qytetarët dhe palët e interesit

Në kuadër të përgatitjes së raportit “Pasqyra e Perceptimeve të Qytetarëve për Pellgun Ujor të Drinit të Bardhë në Kosovë”, është organizuar një sesion diskutimi online me qëllim të mbledhjes së perceptimeve, shqetësimeve dhe rekomandimeve të qytetarëve dhe profesionistëve të fushave të ndryshme lidhur me gjendjen e Pellgut Ujor të Drinit të Bardhë. Sesioni është mbajtur me datë 6 korrik 2026, prej orës 11:00 deri në ora 12:00.

Në këtë sesion morën pjesë gjithsej **21 pjesëmarrës**, të cilët përfaqësonin profile të ndryshme profesionale dhe akademike. Diversiteti i pjesëmarrësve ka mundësuar një diskutim ndërdisiplinor, duke përfshirë perspektiva nga fusha e mjedisit, inxhinierisë, arsimit, gazetarisë, ekonomisë dhe studentëve të profileve të ndryshme.

Profesionet e deklaruara nga pjesëmarrësit gjatë procesit të regjistrimit përfshinin:

- Studente të Inxhinierisë së Ambientit
- Inxhinierë të Ndërtimtarisë
- Gazetarë
- Studente dhe studentë të profileve të ndryshme
- Ekologe
- Inxhinierë të Mjedisit
- Inxhinier të Hidroteknikës
- Ekonomist
- Zyrtar për Zhvillim të Karrierës
- Operator i menaxhimit elektronik dhe praktikant në zyrën e karrierës në Universitetin “Haxhi Zeka”
- Teknologe
- Profesionistë nga sektori i bankave dhe financave
- Profesor i shkencave natyrore
- Profesor i Gjeografisë
- Arkitekte
- Praktikantë

Rrjedha e sesionit dhe temat e diskutimit

Sesioni filloi me një prezantim të shkurtër informues nga Rilindja Gjelbër, ku u dha informata mbi Pellgun Ujor të Drinit, rëndësinë e tij ekologjike, sfidat kryesore me të cilat përballet dhe rolin e qytetarëve në mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore.

Pas prezantimit, u hap diskutimi i lirë me pjesëmarrësit, ku fokusi kryesor ishte në identifikimin e problemeve që ndikojnë në gjendjen e pellgut ujor, si dhe në diskutimin e mundësive dhe masave që mund të ndërmerren për përmirësimin e situatës. Në veçanti u diskutuan problematikat që lidhen me komunat Pejë, Gjakovë, Deçan dhe Prizren, të cilat janë pjesë e

rëndësishme e Pellgut të Drinit të Bardhë dhe përballen me sfida të ndryshme në menaxhimin dhe mbrojtjen e burimeve ujore.

Sfidat kryesore të identifikuara

Bazuar në diskutimet gjatë sesionit online, pjesëmarrësit identifikuan disa nga sfidat kryesore që ndikojnë në gjendjen e Pellgut Ujor të Drinit të Bardhë:

- **Ndotja e ujërave**
- **Ndërhyrjet e pakontrolluara në shtretërit dhe rrjedhat e lumenjve**
- **Shpyllëzimi**
- **Ndryshimet klimatike**
- **Thatësirat dhe mungesa e ujit gjatë periudhave të thata**

Pjesëmarrësit theksuan se këto probleme janë të ndërlidhura dhe ndikojnë drejtpërdrejt në biodiversitetin, cilësinë e ujit, sigurinë e furnizimit me ujë dhe mirëqenien e komuniteteve lokale.

Ndërhyrjet në lumenj dhe degradimi i ekosistemeve ujore

Një nga temat më të diskutuara gjatë sesionit ishte ndikimi i ndërhyrjeve njerëzore në rrjedhat lumore. Pjesëmarrësit shprehën shqetësime lidhur me:

- **nxjerrjen e zhavorrit nga operatorë joformalë ose jashtë kërkesave ligjore;**
- **betonizimin dhe ndryshimin e shtretërve natyrorë të lumenjve;**
- **dëmtimin e habitateve natyrore dhe vegjetacionit përgjatë brigjeve të lumenjve;**
- **mungesën e kontrollit dhe monitorimit të vazhdueshëm nga institucionet përgjegjëse.**

Sipas pjesëmarrësve, këto ndërhyrje kanë ndikim të drejtpërdrejtë në funksionimin natyror të ekosistemeve lumore, duke rritur rrezikun nga erozioni, humbja e biodiversitetit dhe përkeqësimi i cilësisë së ujit.

Ndikimi i hidrocentraleve në rrjedhat ujore

Një pjesë e rëndësishme e diskutimit u fokusua në ndikimin e hidrocentraleve të vogla në degët e Drinit të Bardhë. Pjesëmarrësit ngritën shqetësime lidhur me ndërtimin dhe funksionimin e disa hidrocentraleve, veçanërisht në zona të ndjeshme ekologjike dhe zona të mbrojtura.

Sipas diskutimeve, problematika kryesore lidhet me:

- **ndërtimin e hidrocentraleve në zona me rëndësi të lartë natyrore;**
- **reduktimin e rrjedhës natyrore të ujit për shkak të devijimit të sasive të mëdha të ujit;**
- **ndikimin në biodiversitetin ujor dhe vegjetacionin përreth lumenjve;**
- **dëmtimin e vazhdimësisë natyrore të rrjedhave lumore.**

Pjesëmarrësit përmendën raste konkrete ku hidrocentralet kanë shkaktuar shqetësime te komunitetet lokale, veçanërisht në zonat malore të Kosovës, duke përfshirë edhe diskutimet e vazhdueshme rreth ndikimit të hidrocentraleve në rajonin e Pejës dhe zonave të tjera të Pellgut të Drinit të Bardhë.

Kjo çështje është diskutuar për vite me radhë në Kosovë, ku përveç shqetësimeve të ngritura gjatë sesionit online, janë analizuar edhe reagimet publike dhe qëndrimet e qytetarëve në raste të ndryshme të planifikimit ose ndërtimit të hidrocentraleve. Këto reagime tregojnë shqetësimin e komuniteteve lokale për ndikimet potenciale në burimet ujore, biodiversitetin dhe përdorimin tradicional të lumenjve, qysh vite më parë.

Problemet ndërkufitare dhe ndikimi i ndotjes në rrjedhat ujore të Pellgut të Drinit të Bardhë

Gjatë sesionit të diskutimit online, pjesëmarrësit ngritën çështjen e ndikimeve ndërkufitare të ndotjes së ujërave, duke theksuar se lumenjtë dhe rrjedhat ujore nuk kufizohen nga kufijtë administrativë dhe se problemet e krijuara në një territor mund të ndikojnë drejtpërdrejt në komunitetet dhe ekosistemet e vendeve fqinje.

Një nga karakteristikat kryesore të Pellgut të Drinit të Bardhë është pikërisht natyra e tij ndërkufitare. Drini i Bardhë, me gjatësi rreth 122 kilometra, buron në Radac të Pejës dhe përshkon pjesën më të madhe të territorit të Kosovës para se të kalojë drejt territorit të Shqipërisë në Kukës. *Për këtë arsye, ndotja e krijuar përgjatë rrjedhës së tij nuk mbetet e kufizuar brenda territorit të Kosovës, por transportohet përmes sistemit ujor drejt zonave kufitare dhe më tej në Shqipëri.*

Gjatë diskutimit, pjesëmarrësit përmendën rastet kur komunitetet në rajonin e Kukësit në Shqipëri kanë ngritur shqetësime lidhur me mbetjet që transportohen përmes rrjedhave ujore nga territori i Kosovës, duke ndikuar në cilësinë e ujit, peizazhin dhe kushtet mjedisore në zonat përreth. U theksua se menaxhimi jo i duhur i mbetjeve në pjesët e sipërme të pellgut mund të krijojë pasoja të drejtpërdrejta në zonat e poshtme të rrjedhës së lumit. (MjedisiSot, 2026)

Pjesëmarrësit theksuan se ndotja ndërkufitare nuk lidhet vetëm me mbetjet e ngurta, por edhe me shkarkimet e ujërave të ndotura, mungesën e sistemeve adekuate të menaxhimit të mbetjeve, si dhe ndërhyrjet e ndryshme që ndikojnë në cilësinë ekologjike të lumenjve. Në këtë kuadër, u theksua se mbrojtja e burimeve ujore kërkon një qasje të përbashkët ndërmjet institucioneve, komuniteteve dhe organizatave mjedisore të vendeve që ndajnë të njëjtat sisteme ujore.

Kjo problematikë u lidh edhe me raste të tjera rajonale që tregojnë natyrën ndërkufitare të ndotjes nga mbetjet. Një shembull i diskutuar ishte rasti i vitit 2025 në Dubrovnik, Kroaci, ku pas reshjeve dhe lëvizjeve të forta detare, sasi të mëdha mbetjesh, përfshirë plastikë, u transportuan drejt bregdetit kroat prej Shqipërisë. Ky rast nxori në pah nevojën për bashkëpunim rajonal në parandalimin e ndotjes dhe menaxhimit të mbetjeve, pasi ndotja e ujërave mund të kalojë kufijtë shtetërorë dhe të ndikojë në zona shumë më të largëta nga burimi i saj. (Hassan, 2025)

Bazuar në diskutimet gjatë sesionit, pjesëmarrësit theksuan nevojën për:

- forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe Shqipërisë, si dhe shteteve tjera fqinje për menaxhimin e burimeve ujore;
- krijimin e mekanizmave të përbashkët për monitorimin e ndotjes dhe shkëmbimin e të dhënave;
- monitorim më të mirë të pikave ku mbetjet mund të hyjnë në rrjedhat ujore;
- përmirësimin e sistemeve të menaxhimit të mbetjeve në komunitetet përgjatë lumenjve;
- reduktimin e hedhjes së mbetjeve në afërsi të rrjedhave ujore;
- rritjen e ndërgjegjësimit të komuniteteve për ndikimin që veprimet lokale mund të kenë në zona të tjera përgjatë pellgut.

Diskutimi evidentoi se Pellgu i Drinit të Bardhë duhet të trajtohet si pjesë e një sistemi të vetëm ujqor rajonal, ku mbrojtja e tij kërkon koordinim përtej kufijve administrativë dhe shtetërorë. Përgjegjësia për ruajtjen e këtij lumi nuk përfundon në kufijtë e Kosovës, por shtrihet përgjatë gjithë rrjedhës së tij, duke kërkuar bashkëpunim të vazhdueshëm ndërmjet Kosovës, Shqipërisë dhe komuniteteve që varen nga këto burime ujore.

Sfidat institucionale dhe qeverisja e burimeve ujore

Përveç sfidave mjedisore, pjesëmarrësit diskutuan gjerësisht edhe pengesat institucionale që ndikojnë në menaxhimin e Pellgut të Drinit të Bardhë. Një nga shqetësimet më të shpeshta ishte **mungesa e koordinimit ndërinstitutional**, si në nivel qendror ashtu edhe ndërmjet institucioneve qendrore dhe komunave.

Pjesëmarrësit vlerësuan se aktualisht mungon një mekanizëm efektiv bashkëpunimi ndërmjet ministrive përgjegjëse për mjedisin, ujërat, bujqësinë, energjinë dhe zhvillimin ekonomik, gjë që shpesh rezulton në vendimmarrje të fragmentuar dhe zbatim të dobët të politikave për mbrojtjen e burimeve ujore.

Në këtë kontekst, u theksua rëndësia e **Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore (ARPL)**, i cili u konsiderua si institucioni kyç për koordinimin e menaxhimit të pellgut. Megjithatë, pjesëmarrësit vlerësuan se ky institucion duhet të ketë një rol më aktiv në monitorimin e gjendjes së lumenjve, koordinimin ndërinstitutional dhe zbatimin e masave konkrete për mbrojtjen e ujërave. Gjithashtu, u propozua që organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarët të ushtrojnë më shumë presion publik ndaj institucioneve përgjegjëse për të përshpejtuar ndërmarrjen e veprimeve konkrete.

Gjatë diskutimit u përmend edhe fakti se disa komuna kanë kërkuar mbështetje teknike dhe financiare për rregullimin e shtretërve të lumenjve dhe rehabilitimin e zonave të degraduara, duke treguar se kapacitetet lokale shpesh janë të pamjaftueshme për të adresuar problemet ekzistuese.

Pjesëmarrësit theksuan gjithashtu se ndërhyrjet aktuale janë përqendruar kryesisht në **adresimin e pasojave dhe jo të shkaqeve të problemit**. Sipas tyre, organizohen vazhdimisht aksione për pastrimin e lumenjve, mirëpo mbeturinat rikthehen në të njëjtat lokacione për shkak të mungesës së masave parandaluese. U vlerësua se, krahas aktiviteteve të pastrimit, duhet të vendoset theksi në parandalimin e ndotjes përmes përmirësimit të menaxhimit të mbetjeve, zbatimit më të rreptë

të legjislacionit, monitorimit të vazhdueshëm, edukimit të qytetarëve dhe identifikimit të burimeve kryesore të ndotjes. Vetëm një qasje e tillë mund të sigurojë rezultate afatgjata dhe mbrojtje të qëndrueshme të Pellgut të Drinit të Bardhë.

Përfshirja e komunitetit dhe ndërgjegjësimi qytetar

Një tjetër temë e diskutuar ishte rëndësia e përfshirjes së komuniteteve lokale në mbrojtjen e burimeve ujore. Pjesëmarrësit propozuan krijimin ose fuqizimin e **këshillave lokalë për mbrojtjen e ujërave**, të cilët do të shërbenin si mekanizma bashkëpunimi ndërmjet institucioneve, organizatave të shoqërisë civile dhe qytetarëve.

Gjithashtu, u theksua nevoja për zhvillimin e më shumë iniciativave lokale që përfshijnë qytetarët në monitorimin e ndotjes, aksionet e pastrimit dhe raportimin e shkeljeve mjedisore. Sipas pjesëmarrësve, përfshirja aktive e komunitetit është një ndër elementet kyçe për mbrojtjen afatgjatë të Pellgut të Drinit të Bardhë.

Stresi hidrik dhe siguria e furnizimit me ujë

Një nga çështjet që ngjalli debat ishte **rritja e stresit hidrik në Kosovë**, si pasojë e ndryshimeve klimatike, periudhave të zgjatura të thatësirës dhe menaxhimit joefikas të burimeve ujore. Pjesëmarrësit theksuan se, ndonëse Kosova zotëron burime ujore dhe produktet e saj eksportohen në shumë vende, një numër i madh qytetarësh vazhdojnë të përballen me mungesë të furnizimit të rregullt me ujë të pijshëm, veçanërisht gjatë muajve të verës.

Ky kontrast u përdor si shembull i nevojës për një planifikim më të mirë të menaxhimit të ujërave, investime në infrastrukturën e furnizimit dhe mbrojtje më të madhe të burimeve ujore, në mënyrë që prioritet t'u jepet nevojave të qytetarëve dhe qëndrueshmërisë së burimeve për brezat e ardhshëm.

Rekomandimet e dala nga sesioni i diskutimit online

Bazuar në diskutimet e zhvilluara gjatë sesionit online, pjesëmarrësit rekomandojnë:

- **Forcimin e koordinimit institucional** ndërmjet ministrive, Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore (ARPL), komunave dhe institucioneve të tjera përgjegjëse për menaxhimin e burimeve ujore.
- **Kalimin nga masat reaktive në ato parandaluese**, duke u fokusuar në eliminimin e burimeve të ndotjes dhe jo vetëm në pastrimin periodik të lumenjve.
- **Përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve dhe ujërave të zeza**, përmes monitorimit më të mirë, investimeve në infrastrukturë dhe zbatimit të legjislacionit mjedisor.
- **Mbrojtjen e rrjedhave natyrore të lumenjve**, duke parandaluar nxjerrjen e paligjshme të zhavorrit, betonizimin e shtretërve dhe ndërhyrjet që dëmtojnë ekosistemet ujore.
- **Zhvillimin e projekteve hidroenergjetike vetëm pas vlerësimeve të plota mjedisore**, me respektim të rrjedhës ekologjike dhe konsultim të komuniteteve lokale.
- **Forcimin e bashkëpunimit ndërkufitar**, veçanërisht ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, për monitorimin e cilësisë së ujit dhe menaxhimin e ndotjes në Pellgun e Drinit.
- **Rritjen e përfshirjes së qytetarëve dhe komuniteteve lokale** në mbrojtjen e burimeve ujore përmes iniciativave lokale, këshillave për mbrojtjen e ujërave dhe aktiviteteve ndërgjegjëse.

- **Adresimin e ndikimeve të ndryshimeve klimatike dhe stresit hidrik**, përmes planifikimit afatgjatë dhe prioritizimit të sigurisë së furnizimit me ujë për qytetarët.
- **Rritjen e mbështetjes për komunat**, duke siguruar asistencë teknike dhe financiare për rehabilitimin e lumenjve dhe zbatimin e planeve të menaxhimit të pellgjeve ujore.

Diskutimi konfirmoi se mbrojtja e Pellgut të Drinit të Bardhë kërkon bashkëpunim ndërmjet institucioneve, komuniteteve lokale, organizatave të shoqërisë civile dhe qytetarëve, me qëllim të sigurimit të një menaxhimi afatgjatë dhe të qëndrueshëm të këtij burimi natyror.

Pasqyra e shqetësimeve mbi ujërat: Raportime nga aktivistët dhe ekspertë të shëndetësisë

Ky seksion paraqet një përmbledhje të detajuar të të dhënave, dëshmive dhe shqetësimeve të adresuara drejtpërdrejt tek organizata "Rilindja e Gjelbër" nga aktivistë mjedisorë dhe profesionistë të fushës mjekësore në Kosovë. Ky kontribut nga tereni ofron një pasqyrë të qartë mbi gjendjen aktuale të pellgjeve lumore dhe burimeve ujore, duke ndërlidhur degradimin mjedisor me rreziqet potenciale për shëndetin publik. Informacionet e grumbulluara shërbejnë si një alarm direkt nga ekspertët dhe qytetarët e angazhuar, të cilët ballafaqohen çdo ditë me pasojat e ndotjes së ujërave në vend.

Thatësitrat dhe shëndeti publik

Si pjesë e raportimeve të pranuar nga terreni, Dr. Festa Berisha, mjeke e përgjithshme në QMF Zhur (rajon që përfshin burimet ujore nga pellgu i Drinit), ngre alarm për rreziqet shëndetësore që vijnë si pasojë e ekstremeve klimatike.

Më poshtë paraqitet deklarata e saj e plotë:

"Thatësitrat janë një nga kërcënimet më të mëdha mjedisore për shëndetin tonë. Kur reshjet ulen dhe rezervat e ujërave të ëmbël zvogëlohen, qasja në ujë të pastër dhe të sigurt bëhet më e vështirë. Kjo mund të ndikojë në higjienën personale, larjen e duarve, funksionimin e spitaleve dhe përgatitjen e ushqimit, duke rritur rrezikun për infeksione gastrointestinale, sëmundje të lëkurës dhe sëmundje të tjera me etiologji të ndryshme.

Përveç ndikimit të drejtpërdrejtë në shëndet, thatësitrat ulin prodhimin bujqësor, reduktojnë rendimentin e kulturave dhe të blegtorisë dhe rrisin pasigurinë ushqimore. Kjo mund të shkaktojë kequshqyerje, mungesë të mikronutrientëve dhe përkeqësim të gjendjes shëndetësore, veçanërisht tek fëmijët, të moshuarit, gratë shtatzëna dhe grupet me status të ulët socio-ekonomik.

Në të kundërtën e thatësirave, reshjet intensive brenda një periudhe të shkurtër kohore krijojnë sfida të tjera serioze për shëndetin tonë. Përmbytjet që pasojnë mund të tejkalojnë kapacitetin e sistemeve të drenimit dhe të infrastrukturës sanitare, duke shkaktuar ndotje të gjerë të mjedisit. Reshjet e dendura shpëllajnë nga tokat bujqësore pesticide, plehra kimike, nitrate, fosfate, metale të rënda dhe substanca të tjera potencialisht toksike, të cilat përfundojnë në lumenj, liqene, rezervuarë dhe ujëra nëntokësore. Ky proces përkeqëson cilësinë e ujit të pijshëm dhe rrit ekspozimin e popullatës ndaj ndotësve kimikë dhe mikroorganizmave patogjenë."

Kjo tregon se menaxhimi i pellgut të Drinit nuk është thjesht një çështje mjedisore, por një emergjencë e drejtpërdrejtë e shëndetit publik. Zyrtarët shëndetësorë në teren tashmë po shohin lidhjen direkte mes degradimit të burimeve ujore dhe rritjes së rrezikut nga infeksionet dhe toksiciteti kimik për banorët e këtij rajoni.

Në vijim të raportimeve nga terreni, eksperti Enis A. A. Shatri (LL.M.) ka adresuar propozime konkrete dhe teknike rreth menaxhimit të ujërave.

1. Propozimi për menaxhimin e ndotjes ndërkufitare: Vendosja e ndaluesve të plastikës në Gjonaj (Prizren)

Problematika dhe propozimi teknik

Duke marrë shkas nga Raporti i BE-së, i cili konstaton se lumenjtë në Kosovë kanë një nivel të lartë ndotjeje, si dhe nga situata kritike e mbushjes së Liqenit të Fierzës me mbetje plastike nga Kosova dhe Maqedonia e Veriut, propozohet një ndërhyrje e hershme administrative dhe teknologjike:

- Lokacioni i Propozuar: Fshati Gjonaj i Prizrenit (përgjatë rrjedhës së Drinit të Bardhë).
- Teknologjia: Ndërtimi dhe aktivizimi i impianteve gjermane për pastrimin e mbetjeve ujore, të llojit OSSBERGER Trash Rack Cleaners.
- Objektivi: Ndalimi i mbetjeve plastike në kufij administrativë lumorë (komuna, qytete dhe kufij shtetërorë) sipas parimit "*not in my backyard*" (jo në oborrin tim). Kjo do të mundësonte verifikimin e saktë se sa tonë mbeturina gjeneron secila komunë përpara se ato të kalojnë në rrjedhën ndërkufitare. (Ossberger Hydro, 2025)

Shembuj Rajonalë: Ndërtimi i këtyre stabilimenteve sugjerohet të bëhet në pika strategjike në hyrje/dalje të qyteteve apo në grykëderdhjet e lumenjve të mëdhenj si: *Buna, Mat, Ishëm, Erzen, Shkumbin, Seman, Vjosa, Bistrica, etj.*

2. Kuadri ligjor dhe historik i ujërave ndërkufitare

Propozimi mbështetet në analizën e inxhinierit Niko Naska (2013) dhe praktikat historike të trajtimit të ujërave të përbashkëta në rajon, duke theksuar se veprimet e njëanshme (si devijimet e rrjedhave nga Maqedonia drejt Egjeut) bien ndesh me konventat ndërkombëtare.

Për t'iu përgjigjur sfidave të sotme, siç është projekti i përbashkët Shqipëri-Kroaci (2018) për parandalimin e rreziqeve nga ndotja e ujit në Adriatik, Kosova duhet të mbështetet në dy konventa kryesore:

- Konventa e ESPOO (Finlandë, 1991): Mbi vlerësimin e ndikimit mjedisor në kontekst ndërkufitar.
- Konventa e Helsinkit (1992): Mbi mbrojtjen dhe përdorimin e ujërave ndërkufitare dhe liqeneve ndërkombëtare.

3. Ndërlidhja me ekoturizmin: Modelet EV6 dhe Sava Cycle Route

Si argument shtesë për mbrojtjen e lumenjve dhe rigjallërimin e zonave përreth tyre, raporti mbështetet në projektet e suksesshme të Bashkimit Evropian për infrastrukturën e gjelbër:

- EuroVelo 6 (EV6 - "Rruga e Lumenjve"): Itinerar prej 3,650 km që kalon përgjatë Danubit, duke promovuar lëvizshmërinë ekologjike dhe mbrojtjen e korridoreve ujore. (EuroVelo 6 Atlantic - Black Sea, n.d.)

- Sava Cycle Route (EuroVelo 18 e ardhshme): Një shteg prej 1,136 km që lidh katër shtete të rajonit (Slloveni, Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi) përgjatë lumit Sava, duke treguar se si lumenjtë e pastër kthehen në asete të fuqishme ekonomike dhe turistike. (EuroVelo Serbia, n.d.) (A New EuroVelo Route Could Soon Link Slovenia, Croatia, Bosnia & Herzegovina, and Serbia, 2025)

Rekomandimi: Ky model sugjerohet të aplikohet edhe përgjatë rrjedhës së Drinit të Bardhë, duke ndërtuar staza për biçikleta që nxisin turizmin e qëndrueshëm dhe rrisin mbikëqyrjen qytetare ndaj ndotjes.

4. Propozim strategjik: Filtrimi i ujërave të zeza me impiante "ROTO" për mbrojtjen e drinit të bardhë dhe burimeve të ujit të pijshëm

Përmes aplikimit të teknologjisë sllovene ROTO, synohet mbrojtja e ekosistemeve ujore dhe rritja e potencialit të turizmit të aventurës.

Teknologjia e Propozuar: Impiantet "ROTO ECO" (Slloveni)

Për të zëvendësuar derdhjen direkte të gypave të kanalizimit në mjedis, propozohet integrimi i sistemeve inovative sllovene për menaxhimin modern të ujërave:

- Impiantet Familjare dhe Komerciale: Përdorimi i depozitave septike me dy dhoma (nga 1000L e sipër) dhe impianteve purifikuese, të cilat përshtaten sipas kapacitetit (litrave) për shtëpi private, restorante, hotele dhe fabrika. (Small wastewater treatment plants, n.d.)
- Sistemet Komunale (20 deri 500 PE): Për objekte më të mëdha komerciale dhe lagje, ku procesi i purifikimit menaxhohet në mënyrë të automatizuar përmes një kompjuteri të integruar që kontrollon fazat e filtrimit dhe valvulat e shkarkimit. (Innovative systems for modern water management, n.d.)

5. Skema e financimit dhe vendosja e afateve ligjore

Për t'i dhënë zgjidhje këtij problemi pa mbingarkuar ekonomikisht palët, propozohet një model i përbashkët investimi dhe një kuadër strikt kohor:

- Parimi i Bashkëfinancimit (50% me 50%): Gjysma e çmimit të tankerit dhe impiantit të pastrimit të paguhet nga shteti (përmes granteve mjedisore), ndërsa gjysma tjetër nga vetë qytetarët, bizneset, restorantet, fabrikat apo auto-riparuesit.
- Modeli Legjislativ i Shqipërisë (Shembulli i Fierit): Kosova duhet të aplikojë një afat të prerë ligjor për të gjitha bizneset dhe subjektet që shkarkojnë ujëra të ndotura (sipas modelit të Ministrisë së Mjedisit në Shqipëri). (Bizneset, afat deri me 1 qershor për impiantet e pastrimit të ujit, 2018). Pas këtij afati, asnjë biznes që nuk plotëson kushtet e lejes mjedisore dhe nuk ka impiant filtrimi nuk duhet të lejohet të ushtrojë aktivitetin. *"Mbrojtja e mjedisit dhe e jetës së njerëzve është e panegociueshme."*

6. Pikat kritike të ndërhyrjes në Kosovë

Në bazë të ankesave të shumta të qytetarëve, impiantet ROTO duhet të vendosen me prioritet të lartë në:

1. Pellgun e Drinit të Bardhë (Faza V e Menaxhimit të Ujërave të Zeza - Kosova Jugperëndimore).
2. Kanalet e Ujit të Pijshëm: Në gypat e kanalizimeve të shtëpive që derdhen rreth sistemit Ibër-Lepenc dhe në zonat ujëmbledhëse të liqeneve vitale si Badovci, Ujmani dhe Radoniqi.

7. Mbrojtja e bujqësisë: Sistemet Anti-Breshër "DELTA"

Për të mbrojtur rajonet kritike bujqësore të Kosovës si *Skenderaj, Istog, Suharekë, Rahovec dhe Krushë e Madhe/Vogël*, propozohet instalimi i sistemeve lëvizëse ose fikse anti-breshër të bazuara në raketat shkencore të kompanisë gjegjiane **DELTA**:

- Specifikimet Teknike: Raketa me diametër 60 mm, shpejtësi maksimale prej 600 m/s dhe rreze veprimi deri në 7,800 metra, të cilat parandalojnë formimin e breshërit në re duke mbrojtur deri në 95% të kulturave bujqësore (veçanërisht vreshtarinë).
- Infrastruktura: Këto sisteme duhet të funksionalizohen në Rahovec dhe Suharekë, duke u ndërlidhur me stacionet agrometeorologjike ekzistuese dhe duke ndjekur standardet e doracakëve të KNMI-së (Holandë) për vëzhgime meteorologjike precize.

8. Menaxhimi i integruar i resurseve ujore

Rekomandohet që Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, të promovojë dhe investojë në programe të menaxhimit të pellgjeve ujëmbledhëse (Watershed Development) dhe ruajtjes së ujit (Water Conservation).

Këto programe duhet të fokusohen në:

- Rritjen e kapaciteteve për grumbullimin dhe ruajtjen e ujit.
- Parandalimin e erozionit të tokës.
- Përmirësimin e infiltrimit të ujërave nëntokësore.
- Rritjen e disponueshmërisë së ujit për bujqësi dhe konsum.
- Zvogëlimin e efekteve të thatësirave.

Model i suksesshëm për këtë qasje konsiderohet programi i Fondacionit Paani në Indi, i cili ka demonstruar rezultate të rëndësishme në menaxhimin e ujërave dhe luftimin e thatësirave.

9. Rregullimi dhe ndërtimi i ujëmbledhësve

Duke marrë parasysh efektet e ndryshimeve klimatike, rekomandohet:

- Rehabilitimi i ujëmbledhësve ekzistues.
- Ndërtimi i rezervuarëve të rinj për ujë të pijshëm.
- Ndërtimi i rezervuarëve për ujitje të tokave bujqësore.
- Krijimi i sistemeve për mbledhjen e ujërave atmosferike.
- Ruajtja e rezervave strategjike të ujit gjatë periudhave të thata.

Investimet në këtë sektor do të ndihmojnë në sigurinë ujore dhe zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë.

Përmbledhje

Ky raport paraqet një përmbledhje të gjetjeve dhe rekomandimeve të mbledhura në kuadër të procesit konsultues për mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të Pellgut Ujor të Drinit të Bardhë në Kosovë. Raporti është hartuar mbi bazën e tri burimeve kryesore të informacionit: rezultatet e anketës së zhvilluar me qytetarët, diskutimet e zhvilluara gjatë sesionit online konsultues, si dhe rekomandimet e dorëzuara nga pjesëmarrësit.

Ky raport nuk përfaqëson një studim sasior apo statistikisht përfaqësues për popullsinë e Kosovës. Ai paraqet një përmbledhje të perceptimeve, përvojave dhe rekomandimeve të individëve dhe palëve të interesit që shprehën vullnetin dhe gatishmërinë për të marrë pjesë në procesin konsultues. Pjesëmarrja ishte vullnetare dhe përfshiu qytetarë, profesionistë nga fusha të ndryshme, përfaqësues të institucioneve publike, organizatave të shoqërisë civile, sektorit privat, komunitetit akademik dhe aktorë të tjerë të interesit.

Gjetjet e raportit evidentojnë një shqetësim të lartë për ndikimin e ndryshimeve klimatike, ndotjen e lumenjve, menaxhimin e pamjaftueshëm të ujërave dhe nevojën për një qasje më të koordinuar ndërmjet institucioneve dhe komunitetit. Njëkohësisht, raporti përmbledh një sërë rekomandimesh konkrete të propozuara nga profesionistë dhe aktivistë, të cilat lidhen me përmirësimin e menaxhimit të Pellgut të Drinit, forcimin e bashkëpunimit ndërinstitutional, rritjen e investimeve në infrastrukturën ujore, mbrojtjen e ekosistemeve, edukimin mjedisor dhe përfshirjen aktive të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes.

Ky raport synon të shërbejë si një dokument konsultues, duke pasqyruar zërin dhe perspektivat e pjesëmarrësve dhe duke ofruar rekomandime që mund të kontribuojnë në hartimin dhe zbatimin e politikave për mbrojtjen, ruajtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të Pellgut Ujor të Drinit të Bardhë.

Referencat dhe citimet

- A New EuroVelo Route Could Soon Link Slovenia, Croatia, Bosnia & Herzegovina, and Serbia.* (2025, October). Retrieved from MomentumMag:
<https://momentummag.com/a-new-eurovelo-route-could-soon-link-slovenia-croatia-bosnia-herzegovina-and-serbia/>
- Bizneset, afat deri me 1 qershor per impiantet e pastrimit te ujit.* (2018, April). Retrieved from Albanian Construction Portal:
<https://acp.al/news/4348/bizneset-afat-deri-me-1-qershor-per-impianetet-e-pastrimit-te-ujit/>
- EuroVelo 6 Atlantic - Black Sea.* (n.d.). Retrieved from EuroVelo : <https://en.eurovelo.com/ev6>
- EuroVelo Serbia.* (n.d.). Retrieved from EuroVelo: <https://en.eurovelo.com/serbia>
- Hassan, A. (2025, November). *Dubrovnik, Known for Its Beauty, Faces a Mound of New Trash.* Retrieved from The NewYork Times:
https://www.nytimes.com/2025/11/26/world/europe/croatia-trash-dubrovnik-plastic.html?eafs_enabled=false
- Innovative systems for modern water management.* (n.d.). Retrieved from rotoeco:
<https://rotoeco.eu/?lang=en>
- MjedisiSot. (2026, March). *Mjedisi Sot.* Retrieved from MjedisiSot.com:
<https://mjedisisot.info/nga-kosova-ne-shqiperi-si-perfundon-ndotja-ne-liqenin-e-fierzes/>
- Ossberger Hydro. (2025). *Trash Rack Cleaners.* Retrieved from Ossberger Hydro:
<http://www.ossbergerhydro.com/trash-rack-cleaners.html>
- Ramadani, D. (2019, March). *Kallxo.com.* Retrieved from Kallxo.com:
<https://kallxo.com/gjate/a-po-rrezikojne-hidrocentralet-zhdukjen-e-rrjedhave-te-lumenjve/>
- Small wastewater treatment plants.* (n.d.). Retrieved from rotoeco:
<https://rotoeco.eu/waste-water-treatment-plants/?lang=en>